



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 213, Datë 15.12.2020

“MBI  
LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT NR. 199, DATË 12.12.2019.

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, nenit 20, gërma “c”, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, VKM-së nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “c”, të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE- s, Nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve nr. 132/8 prot, datë 11.12.2020, në lidhje me lënien në fuqi të vendimit Nr. 199, datë 12.12.2019,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE me vendimin Nr. 2, datë 10.01.2020, ka miratuar fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSSH sh.a. për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020.
- ERE me shkresën me nr. 201, datë 27.01.2020, ka kërkuar opinion lidhur me vendimin e Bordit të ERE Nr. 2, datë 10.01.2020, palëve të interesuara si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti i Konkurrencës, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë si dhe Shoqata e Furnizuesve të Energjisë Elektrike.
- ERE në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, ka patur një sërë korrespondencash lidhur me plotësimet e dokumentacionit të nevojshëm nga ana e shoqërive OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. si dhe dhënien e argumentave plotësues mbi komponentët e përcaktimit të tarifave të rrjetit të shpërndarjes si dhe çmimeve të shitjes me pakicë.
- Në vijim të situatës së paprecedentë të krijuar nga pandemia COVID-19, për shkak të pamundësisë për zbatimin e parashikimeve të legjislacionit në fuqi sa i përket diskutimit publik e organizimit të seancave dëgjimore me palët e interesit, masave kufizuese të marra nga Qeveria Shqiptare për kufizimin e përhapjes së virusit Covid-19 si dhe në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gërma “c”, nenit 85, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, VKM nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e

gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, nenit 67 dhe 91, pika 4, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenit 15 dhe 22, të “Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE me anë të vendimit Nr. 67, datë 08.04.2020, vendosi pezullimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, OSSH sh.a. për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020, deri jo më vonë se 3 muaj nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Republikën e Shqipërisë.

- Në kushtet e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike dhe të drejtës të klientëve fundorë për të zgjedhur lirisht furnizuesin e tyre të energjisë elektrike, me përjashtim të klientëve fundorë të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për të cilët ERE ka miratuar tarifën e shpërndarjes prej 1.5 lekë/kWh, dhe klienteve të lidhur në nivelin e tensionit 20kV për të cilët ERE ka miratuar tarifën e shpërndarjes prej 3.9 leke/kWh, për të gjithë klientët e tjerë fundorë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tjera të tensionit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të faturojë energjinë e lëvruar bazuar në tarifën mesatare të shpërndarjes së energjisë elektrike prej 4.79 lekë/kWh, të miratuar nga ERE
- Shoqëria OSSH sh.a. nuk ka mundur të paraqesë informacionin e kërkuar në mënyrë të vazhdueshme me anë të një sërë korrespondencash nga ana e ERE lidhur me realizimin e treguesve tekniko-ekonomik dhe financiar të shoqërive përgjatë vitit 2020.
- Parashikimet e shoqërisë OSSH sh.a. të paraqitura në kërkesën për shqyrtimin e aplikimit për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit, për të cilën tashmë me vendimin nr. 2, datë 10.01.2020 Bordi i ERE ka miratuar fillimin e procedurës, nuk mund të merren për bazë për arsye se tashmë jemi në muajin e fundit të vitit 2020, ndaj çdo e dhënë e depozituar më herët ka humbur aktualitetin dhe nuk paraqet një pasqyrë reale të rrethanave të faktit.
- Në aplikimin e paraqitur dhe korrespondencat e mëtejshme me shoqërinë OSSH sh.a, mungojnë të dhëna mbi ndarjen e bazës së rregulluar të asetëve dhe nivelin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për nivelet e ndryshme të tensionit ku operon operatori i sistemit të shpërndarjes (35/20/10/6/0.4 kV).
- Nga vlerësimet e kryera mbi të dhënat e vëna në dispozicion në kuadër të raportimeve periodike llogaritet se tarifat aktuale të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, i mundësojnë shoqërisë OSSH sh.a. të ardhura të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve nga aktiviteti i licencuar.
- Metodologjia për llogaritjen e tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të miratuara nga ERE, bëjnë të mundur korrigjimin e të ardhurave të realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura për vitin paraardhës.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Mbylljen e procedurës të nisur me anë të vendimit Nr. 2, datë 10.01.2020, për shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020.
2. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s Nr. 199, datë 12.12.2019, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2021, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Drejtoria Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin fuqinë juridike që nga 01.01.2021.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**